Teatri i Butrotit (me shkallaren e shek. III para K.), Sarandë

The Butrot Amphitheatre with a staircase of the 3-rd century BC, Sarandë

Qendra e Apollonisë, monumenti i Agonoteteve (shek. II), Fier

The Centre of Apollonia, Buleterion (Pojan, Fier) of the 2-nd century AD

Kështjella Rozafa, vjen nga prehistoria për Rozafën kjo legjendë: Për ndërtimin e kështjellës pononin gjithë ditën tre vëllezër shkodranë. Mirëpo, çdo mëngjes i gjenin muret të shembur! Deri sa një ditë kaloi aty pranë një plak, të cilin e pyetën se ç'mund të bënin për hallin e madh që kishin. Plaku u dha një këshillë; që kështjella të ndërtohej duhej, që njëra nga gratë e tyre të flijohej në themelet e saj. Pasi e peshuan mirë këshillën e tij, të tre burrat ranë dakord që të murosej ajo që do të sillte të nesërmen bukën e drekës. Prandaj vendosën të mos u tregojnë grave. Por, premtimin e mbajti vetëm vëllai i vogël. Të nesërmen kur zonja e shtëpisë urdhëroi nusen e madhe për t'u shpënë bukën burrave, ajo u bë si e sëmurë, e mesmja kishte dalë nga shtëpia, atëherë porosinë e përmbushi nusja e vogël ndonëse me një fëmijë në gji.

- Puna e mbarë! - përshëndeti ajo buzëgaz, si dhe herë tjetër.Asnjëri prej tyre s'u përgjigj! Pas një heshtjeje të gjatë… e me vështrimin përdhe, të zymtë si një re e zezë ata i treguan asaj për vendimin që kishin marrë. Tek murosej, nusja e shkretë u kërkoi ustallarëve që njërin sy, njërin gji, një dorë dhe një këmbë t'ia linin jashtë për të parë, ushqyer me qumësht, përkëdhelur dhe përkundur djalin e saj që kish lënë në djep. Kështu, të nesërmen, muret nuk ishin shembur dhe kështjella u ndërtua. Thonë se njerëzit kanë parë për shumë kohë në një të çarë të muri të kësaj kështjelle që të pikonte një lëng i bardhë si qumësht apo gëlqere.

The Rozafa Castle. The name of this castle comes from a legend of pre-historical Albania: " There were in those times three brothers from Shkodër who worked together the whole day to build the castle. But every morning something strange happened when they went back to work: the walls they had built one day before had fallen apart. One day, an old man passed by, and they asked him what they should do to avoid the big problem they were facing. The old man's advice was that in order for the walls to hold firm, the wife of one of the brothers had to be buried alive there, in the foundations of the castle.

The three brothers took time to think about his advice and then finally agreed that the sacrifice would to be the wife that was going to bring them the lunch the following day. So the three of them promised each other they would tell their wives nothing about this. But only the youngest brother kept the promise.The next day, when the mother of the three brothers asked the eldest daughter-in-law to take the lunch to her sons, she pretended that she was sick. The wife of the second son had left the house earlier. So the youngest wife had to take the meal to the brothers, though she was nursing her baby son."How was your day?"(Alb. "PUNË TË MBARË") she asked when arriving there, smiling, as she was always used to.The three brothers were not able to return their greeting. After a long silence, despaired and with downcast eyes, they told her about their decision.When being walled alive, she asked the three brothers to leave out one of her right eye, her right breast, her right arm, her right leg, so that she could see, feed, hold her son, and rock him gently in his cradle.The brothers saw the next morning that the walls had not fallen. This is how the castle was built.

They say that for a long time, in the walls of this castle there has been a cleft dripping a white liquid that looks like milk, in fact it was lime water.

Berati, qyteti 2400 vjeçar.
A view of the 2400-year-old city of Berat

Hartë e territoreve Ilire.

Map of the Illyrian territories

Kruja

Kruja. Qytet dhe qendër e rrethit me të njëjtin emër me rreth 15000 banorë, i ndërtuar në një shpat të maleve Skënderbe. Në shekullin XIII quhej Bistrem Albanum, sepse gjendej në afërsi të Albanopolit.
Ptolemeo e citon si qytezë ilire e shek. III. Në shekullin XIII bëhet qyteti i mbretit Karl Anjou. Në vitin 1405 lindi Gjergj Kastriot Skënderbeu. U pushtua nga turqit në 1415. Çlirohet nga Skënderbeu në 1443. Ka qenë në qendër të vëmendjes për gjithë Evropën deri në vitin 1468 kur vdiq Skënderbeu, i cili me luftrat e forta që bëri kundër pushtuesve osmanë, jo vetëm u dha lirinë shqiptarëve, por shpëtoi edhe krishtërimin evropian.
Në vitin 1478 ripushtohet nga Turqia. Pazari karakteristik është dëshmi e zhvillimit tregtar dhe artizanal të shek. XVI. Kalaja e Krujës dhe muzeu i ri janë simbol i forcës së Skënderbeut dhe gjithë shqiptarëve.

Krujë, built on the mountainside of a rocky mountain (part of the mountain chain of Dajti located in the border of Tiranë). In the 13-th century it was called Bistrem Albanum, since it was located close to Albanopolis.
Ptolemy mentions it as an Illyrian fortress of the 3-rd century. During the reign of Charles of Anjou, Krujë became the capital of the Kingdom of Albania, in the 13th century. George Castriot Scanderbeg was born there in 1405. Krujë was invaded by the Ottomans in 1415. It was liberated by Scanderbeg in 1443. This city was in the centre of attention of all Europe for 25 years, till 1468, when Scanderbeg, who had saved Albania and European Christianity, died.
The Ottomans recaptured Krujë in 1478. The characteristic old bazaar, still intact at present, is an evidence of the trade and handicraft, which flourished during the years 1600-1700.

Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Hero Kombëtar (vepër e skulptorit të popullit Janaq Paço), Krujë.

George Castriot Scanderbeg, the National Hero (the master-piece of the well-known sculptor, Janaq Paço, Krujë)

Muzeu Kombëtar "Skënderbeu", Krujë.

The "Scanderbeg" National Museum in Krujë

Pazari i vjetër mesjetar, Krujë.

The Old Marketplace of the medieval period, Krujë.

Oxhaku i një shtëpie krutane

Chimney of a house in Kruja

Lezha

Lezha. Qyteti i lashtë (Lisi-Lissus), sot me rreth 31000 banorë është themeluar në vitin 385 para K. nga Dionisi, Tirani i Sirakuzës. Si shumë qytete të Shqipërisë është pushtuar shpesh nga romanë, venecianë, serbë dhe osmanë. Në Lezhë më 1444 Skënderbeu bëri Kuvendin e bashkimit të shqiptarëve për luftë kundër Turqisë. Po aty vdes më 17 Janar 1468. Pas pushtimit, osmanët, katedralen e vendvarrimit të Skënderbeut e kthyen në teqe.Sot është qytet-muze i varrit të Heroit Kombëtar, Skënderbeut. Mbi qytet ndodhet një kështjellë mesjetare. Këto objekte dhe muret antike në qendër të qytetit janë dëshmi dhe vlera kulturore nga lashtësia e qytetit, të cilat së bashku me bregdetin e Shëngjinit mund të shërbejnë për zhvillimin e turizmit.

Lissus, today's Lezhë, a town with a population of about 31,000 inhabitants, was founded in the year 385 B.C. by Dionysius, the tyrant of Syracuse. Like many other cities of Albania, it was often invaded by the Romans, the Venetians, the Serbs, and the Ottomans.
Scanderbeg gathered in Lezha in 1444 the League of Lezhë which aimed at uniting the Albanians in the war against the Ottomans. Lezhë is also the city where Scanderbeg breathed his last and was buried. After his death, the Ottomans transformed his chapel into a tekke. Today it serves as the museum of the tomb of the National Hero, George Castriot – Scanderbeg. Above the town there is a medieval castle. These objects and the ancients city walls downtown are a cultural treasure and witness for the ancient origin of the town, which, along with the Shengjin beach, make up an asset for the development of tourism.

Vendvarrimi i Gj.K. Skënderbeut
Burial place of Gj.K.Scanderbeg

Hotel "Gjuetia" në Ishull Lezhë.
The Hotel of the Hunters in the Isle of Lezhë.

Plazhet të Shëngjinit, Lezhë.

The Shëngjini Beachs, Lezhë.

Vështrimi nga kalaja Rozafa
View from Rozafa castle

Portat e Kështjellës Rozafa, Shkodër.
The gates of the Rozafa Castle, Shkodra

Nga qendra e qytetit të Shkodrës
View from the city of Shkodra

Ura e Mesit (mesjetë), Shkodër

The Mesi Bridge (Middle Ages) Shkodra

Porsi kanga e zogut t'verës,
që vallzon n'blerim të prillit,
porsi i ambli fllad i erës
që lëmon gjijt e trandafilit,
porsi vala e bregut të detit.
Porsi gjama e rrf'esë zhgjetare,
porsi ushtrima e një tërmetit,
nj'ashtu asht gjuha jonë shqiptare.

Our Albanian tongue
Is like the song of the summer's bird
Dancing in April's green,
like the sweet summer's breeze
Caressing the breasts of the rose,
Like the wave kissing the shore,
Like the thundering of the shocking bolt,
Like the earthquake roar…
Such is our Albanian language.



Gjergj Fishta

Lumi Bunë (peizazh), Shkodër.
The Buna River (a landscape), Shkodra

Plazhi i Velipojës, Shkodër
The Velipoja Beach, Shkodra

ULQINI

Ulqini, qytet shqiptar në Malin e Zi, një nga trevat më të lashta dhe më të rëndësishme pas Durrësit në brigjet e Adriatikut, dëshmon për vazhdimësinë e jetës dhe qytetërimit prej kohës prehistorike, antike, mesjeta e herëshme, e vonshme e deri në ditët tona. Brenda mureve të kalasë së Ulqinit antik është zbuluar bedeni ilir, i ndërtuar me blloqe të mëdhenj guri, të ashtuquajtura këto mure "qiklopikë". Plini i Vjetër shkruan se Ulqini antik (Olcinium) më parë është quajtur Colchinium, që ka të bëjë me Kolkët nga Azia, si themelues të këtij qyteti. Edhe Tit Livi e përmend Ulqinin si Olinium. Ndërsa, vendasit e fisit ilir, Labeate, e quanin Olciniatas. Të tjerë historianë kanë pohuar se ulqinakët i përkisnin fisit ilir të Taulantëve, të cilët kishin mbret Gentin dhe u qëndruan romakëve deri sa u bënë aleatë duke fituar statusin e qytetit të pavarur apo të municipiumit. Në kohën e Dioklecianit, kur bëhet ndarja e Perandorisë Romake, Ulqini mbetet në Perandorinë Lindore. Në këtë kohë Ulqini, megjithëse kishte peshkopatën e vet, varej nga kryepeshkopata e Tivarit dhe kisha e Shkodrës.
Në shek.IX sulmohet nga perandori maqedon Samuil. Në shek XII-IV, brenda Kalasë së Ulqinit ndërtohen kishat e Zonjës së Bekuar, Shën Jovanit, Shën Dominikut, etj. Gjatë kësaj periudhe këtu sunduan edhe nipi i Nemanjës, Gjorgji, vejusha Helena e Anzhuinëve dhe motra e saj, Maria. Pastaj për rreth një shekull sundon dinastia e Ballshajve dhe deri më 1571 sundon republika e Venedikut, rreth 150 vjet. Gjatë shek.XVI-XVII të pushtimit turk, zhvillohet detaria, zejtaria, tregtia, etj. Flota e Ulqinit kishte rreth 500 anije me vela që lundronin deri në Mesdhe. Prandaj, edhe qyteti shpërthen jashtë mureve të kalasë duke u ndërtuar xhami, tyrbe, sahatkulla, etj, sipas stilit oriental. Në krahinën e Anës së Malit, 22 km larg Ulqinit ndodhet "Qyteti i Vdekur" i Shasit. Nëpër të kalonte rruga romake Ulcinium-Scodra. Pranë Shasit janë gjetur gjurmë të një vendbanimi ilir. Në dorëshkrimet e gjetura pohohet se Shasi ishte qytet antik me gjurmë të themeleve e mureve të 360 kishave, aq sa ditë ka viti. Ulqini sot ka rreth 25000 banorë, kryesisht shqiptarë. U aneksua nga Mali i Zi më 1880. Eshtë port detar dhe qendër turistike.

Ulqini, an Albanian town in Montenegro, one of the most ancient and most important settlements on the Adriatic seacoast, ranking second after Durres, has evidence for the continuity of life and civilization from primeval ages, ancient times, early Middle Ages, late Middle Ages, up to the present times. Illyrian ramparts, built with huge stone blocks without mortar, known as 'cyclopean' walls, have been discovered inside the surrounding walls of the Castle of ancient Ulqin. The Roman historian Titus Livy (59 BC 17 AD) mentions Ulqin as Olinium. The Roman scholar Gaius Pliny the Elder (AD 23-79) writes that ancient Ulqin (Olcinium) was formerly called Colchinium, related to the Colchinians from southern Caucasus as founders of this town. Whereas the natives of the Illyrian tribe of Labeates called it Olciniatas. Other historians refer to the Ulqin natives as belonging to the Illyrian tribe of the Taulants, whose king was Gent and who resisted the Roman invasion until they became allies and gained the status of a municipality or local self-government. During the time of Diocletian (245-313), after the schism of the Roman Empire, Ulqin remained under the Eastern (Byzantine) Empire. At that time Ulqin, though it had its own episcopate, was under the jurisdiction of the archdiocese of Tivar and the Church of Shkodra.

In the 9th century it was invaded by the Macedonian emperor Samuil. In the 12th-14th centuries the churches of Blessed Virgin Mary, of St. Jovan, of St. Dominic, etc. were built inside the Castle of Ulqin. During this period Ulqin was ruled by Nemania's nephew, Georgi, the widow Helen of Anjou, and her sister, Maria.

Then, for about a century, it was ruled by the Balsha dynasty. Afterwards, for about 150 years, until 1571, it was ruled by the Venetian Republic.

During the Ottoman rule in the 16th-17th centuries, Ulqin saw the development of seamanship, handicraft, trade, etc. The fleet of Ulqin had about 500 sailboats which sailed up to the Mediterranean Sea. Therefore, the town expanded outside the walls of the Castle and new mosques and shrines, a clock tower, etc. were built in Oriental style.

Çast fëminor, Ulqin
Childish moments, Ulqin

Argjendarpunues, Ulqin
Silversmith, Ulcin



Në stinën e
dimrit Ulqin

Winter in Ulqin

Bregu i pishave, Ulqin

Cost of pines, Ulcin

Malet, liqeni, shkembinjte
Nen nje pelhure gri mbeshtjelle.
Shasi, qytet i vdekur,Vranina
Sinjale te larget gjithe mister,
Buna rreze Rozafes,materie detit i percjell.

Autori

Mountains, lakes, and rocks,
Wrapped in grey clothes.
Shazi, a dead city, Vranina,
Distant signals pregnant with mystery,
Buna, under Rozafa's feet, sends food to the sea.

The Author

Liqeni i Shkodrës, Vraninë, (Mali i Zi)
The Shkodra Lake, Vraninë, (Monte Negro)

Veshje të shqiptarëve etnik Plav-Guci (Mali i Zi)

Wear of ethnic Albanians in the region of Plave-Guci (Montengro)

THETHI

Theth is a picturesque valley surrounded by tall rocky mountains; a river with crystal-clear waters issuing from underground at the head of the valley, by the foot of Jezerca Mount. It is one of the most beautiful regions in the Albanian Alps.
The highlanders, permanent residents of this region, have won a reputation as brave and loyal warrior and are highly respected by all Albanians. They have always lived in freedom: neither the Turks nor the Serbs could invade their impregnable domains.
The mountaineers of this region are renowned as brave fighters for freedom and esteemed by all the other Albanian regions. They have always lived free, unconquered by the Turks and Serbs. The inhabitants of the mountainous region are chiefly Catholics, and they are distinguished for their hospitality. The Tribal Law of Lek Dukagjini is the system of the norms, which regulate the social relations among the inhabitants of this region.

Thethi, luginë piktoreske e rrethuar nga male shkëmbore të lartë me lumin e kaltër që buron në krye të luginës rrëzë Jezercës. Eshtë një nga krahinat më të bukura në Alpet e Shqipërisë.
Malësorët e saj janë shquar si luftëtarë legjendarë të respektuar prej gjithë trevave të tjera shqiptare. Ata kanë jetuar të lirë, pa i'u nënshtruar as turqve e as serbëve. Banorët janë kryesisht të fesë katolike dhe shquhen si mikpritës. Natyra ka krijuar premisa për zhvillimin e një shoqërie të rreptë e me karakter të veçantë. Kanuni (kod zakonor) i mbledhur nga Lek Dukagjini është kompleksi i normave që rregullon raportet shoqërore ndërmjet banorëve të kësaj zone.

Lahuta e këngëve të malësisë, Shkodër
The lute of the highland epic songs, Shkodra

Theth

HC Vau Dejës

HC Koman

Hirdocentrali i Komanit, Vaut të Dejës dhe ai Fierzës mbi lumin Drin.

The hydro-electric power stations of Fierza, Koman, and of Vau i Dejës.

HC Fierzës



"Arterie"

"Arteries"

Lugina e krahinës se Lek Bibajt, Tropojë
The Valley of Lek-Bibaj Region, Tropoja

Mitrush Kuteli, njëri nga të mëdhenjtë,veprimin vrullmadh të veçuar dhe të përbashkët të heronjve dhe luftëtarëve të librit me titull "Tregime të moçme shqiptare", ku përfshihen legjenda të moçme, ngjarje historike, balada, rapsodi popullore, etj, të mbledhura te malësorët tanë të veriut dhe tek arbëreshët, mbase me prejardhje ilire, por të ndryshuara gjatë shekujve, do ta krahasonte si vijon:

"Tërë kjo mori afshesh shpirtërore, luftarake, hovmadhe, është si të thuash, një farë lumi bjeshkësh që niset nga gurrat dhe krojet e shkëmbenjve, rrjedh rrëmbyeshëm e kumbonjës, kapërcen pragje shkëmbinjsh. Bëhet livar i shkumëzuar, thërmitet në stërkala tek të cilat shndëritin të gjitha ngjyrat e ylberit, bashkohen prapë, del në një fushëtirë të butë, kalon disa grima qetësisht nëpër një amëzë të shtruar, pastaj vërtitet rishtas nëpër ngushtica dredha-dredha, egërsohet, buçet, sulmon, godet, çan udhë fitimtar".

***Mitrush Kuteli**, one of the greatest Albanian prose writers, wrote a book entitled "Ancient Albanian Tales" which includes ancient legends, historical non-fiction, ballads, folkloric rhapsodies, etc. They were collected in the Northern Highlands of Albania and from among the Arbëreshis of Italy, and they might be of Illyrian origin, but they have undergone changes in the course of centuries. The author uses the following simile to describe the individual and collective vehement exploits of the Albanian heroes and fighters in this book:*
"All this immense, combative and impetuous spiritual drive resembles a mountainous river which starts from the cliffs and flows out impulsively, vibrant, gurgling, rushing headlong over the rocks. It becomes a foamy chain, which crashes and sprinkles into splashes sparkling in rainbow colour; then it is unified again and flows for a while through a smooth meadow, quietly, over the pebbles. Then, it precipitates again through zig-zag clefts, rages, rumbles and roars, attacks and strikes and rushes ahead unrestrained and victorious."

Ditë dimri në luginën e Valbonës
The winter in the Valley of Valbona

Mali i Jezercë, Tropojë
Jezerca Mountain, Tropoja

KUKËSI

Kukësi, është një qytet në Shqipërinë verilindore.
Si vendbanim që nga periudha e neolitit është Kolshi, në të dy anët e lumit Drin. Të periudhës ilire, janë: Cinomak, Tumat Bardhoc, Knet, Pobreg, etj. Si objekte të periudhës mesjetare janë: Kalaja e Gradishtit Bardhoc, Bushat Pecës dhe Kalaja Iasai-Domej. Kukësi, si qytet ngrihet aty ku bashkohen lumenjtë Drini i Zi me Drinin e Bardhë. Ka një popullsi prej rreth 30000 banorë. Pas përmbytjes së qytetit të vjetër nga liqeni i hidrocentralit të Fierzës, qyteti është ndërtuar i ri dhe tani ka një panoramë të re në këmbët e malit Gjallica, ne formën e një gadishulli që rrethohet nga liqeni piktoresk i Fierzës. Ndërtimi i rrugës së re Durrës-Kosovë që kalon përmes Kukësit dhe Aeroporti i ri, do të gjallërojë më tej jetën e këtij qyteti.

Kukës is a town in Northeastern Albania. Kolsh, an ancient settlement of the Neolithic Age, is situated on both sides of the Drin River. Cinomak, the tumuli (barrows) of Bardhoc, Knet, Pobreg, etc., belong to the Illyrian period. The Castle of Gradisht Bardhoc, Bushat Pecës, and the Castle of Isai-Domei are objects of the medieval period. As a town Kukës is situated at the junction of the Black Drin and the White Drin. It has a population of 30,000 inhabitants. After the old town had been inundated by the lake of the Fierza hydro-power station, the new town of Kukës was built at the foot of the Gjallica mountain, creating a new landscape with the surrounding attractive lake. The construction of the new road Durrës- Kosova, which passes across this town, and the new Airport enlivening more and more the town-life of Kukës.

PRIZRENI

Prizreni, qytet pranë një vargu malor mbi 2000 m të lartë. Si qytet në rrugëkalim që nga koha e lashtësisë, Therandë, siç quhej atëherë, kjo qendër e ilirëve dardanë 6 km në verilindje të Prizrenit të sotëm, lidhej me degëzimin e Egnatias nga Lisi (Lezhë) në Pikaria (Pukë) duke u ngjitur nëpër luginën e lumit Drin dhe zgjatej pastaj deri në Ulpianë e më tej. Me emrin Prizëren njihet në shek.XI kur mbi disa rrënoja të periudhës ilire ndërtohet kalaja, muret e së cilës duken edhe sot në kodrën mbi qytet. Zgjerohet me Varoshin dhe merr funksione si qendër politike-administrative, fetare, kulturore dhe ekonomike. Në vitin 1204, Prizreni bie nën sundimin bullgar dhe më 1282 nën atë serb. Më 1455 pushtohet nga turqit. Me organizimin e ri administrativ të Perandorisë Osmane, në vitin 1868, Prizreni u caktua si qendër vilajeti me shtrirje nga

Elbasani, Mati deri në Vranjë e Nish. Në këtë kohë ka patur edhe përfaqësi diplomatike të Austrisë, Rusisë, Anglisë dhe Italisë. Në periudhën e mesjetës së vonë Prizreni si qytet nyje komunikacioni zhvillohet ekonomikisht, merr pamje orientale dhe bëhet një nga qytetet më të mëdhenj në Ballkan me rreth 46000 banorë. Banorët e kësaj treve shquhen për tradita kulturore dhe patriotizëm. Në Prizëren u organizua më 10 qershor 1878 Lidhja Shqiptare e Prizrenit, nën drejtimin e Iljaz Pashë Dibrës, Ymer Prizrenit, Abdyl Frashërit, haxhi Shaban Prizrenit dhe Sulejman Vokshit, e cila është një nga ngjarjet më të shënuara në historinë e Rilindjes Kombëtare shqiptare të luftës për mbrojtjen e tërësisë territoriale të vendi dhe për çlirim kombëtar. Aktualisht, Prizreni ka një popullsi prej rreth 100000 banorë.

Prizreni is a town near a mountain-chain over 2000 m high. Its ancient name was Theranda, situated 6 km northwest of present-day Prizëren, which was the urban centre of the Illyrian tribe of the Dardans. It has been a crossroads since the ancient times linked with a branch of Via Egnatia coming from Lissus (Lezha) to Pikaria (Puka) up the valley of the Drin River and then stretching up to Ulpianë and beyond. It was known by the name of Prizëren in the 11th century when the castle was built on some ruins of the Illyrian times, whose walls are still visible on the hill overlooking the town. Then it expanded by including Varosh and became a political, administrative, religious, cultural and economic centre. In the year 1204 Prizren was invaded by the Bulgarians, and in 1282 it was invaded by the Serbs. In 1455 it was occupied by the Ottomans. According to the new administrative organization of the Ottoman Empire, in the year 1868, Prizëren became

the centre of a 'vilayette' (domain) stretching to Elbasan, Mat and up to Vranjë and Nish. At that time it also had diplomatic representation of Austria, Russia, England, and Italy. During the late Middle Ages Prizëren, as an urban centre of intersecting roads, developed economically, assumed oriental features and became one of the largest cities in the Balkans with a population of about 46,000 inhabitants. The people of this region are renowned for their cultural and patriotic traditions. On June 10th, 1878 in this city there was organized the Albanian League of Prizëren under the leadership of Iljaz Pashë Dibra, Ymer Prizreni, Abdyl Frashëri, Haxhi Shaban Prizreni, and Sulejman Vokshi. The founding of the Prizëren League is one of the most remarkable events in the history of the Albanian National Revival fighting for the defence of the territorial entirety and national liberation of the country. At present Prizëren is a city with a population of about 100,000 inhabitants.

Objekte nga periudha e neolitit, Prizren.
Objects of the Neolithic Age, Prizren.

Pashko Vasa



Abdyl Frashëri

Kompleksi monumental i Lidhjes së Prizrenit.
The memorial complex of the Prizren League.

Prizren

GJAKOVA



Gjakova

Gjakova, qytet në Rrafshin e Dukagjinit midis Prizrenit dhe Pejës. Ndodhet në kryqëzimin e rrugëve Shkodër-Kosovë (në antikitet njihej si Via de Zenta) me rrugën që përshkon qytetet kryesore të Rrafshit Pejë-Gjakovë- Prizren. Qyteti rrethohet prej lumit Erenik dhe degët e tij Trakanica dhe Krena.

Gjurmët e lashtësisë së Gjakovës shkojnë në periudhën ilire të dardanëve. Gjetjet në rrënojat përtej urës së Tabakëve në anën perëndimore të lumit Erenik, mendohet se i përkasin qytetit antik Grabuleo, emërtim ky i hasur në hartat e shek.I-IV. Periudha mesjetare karakterizohet nga ndërtime ushash, dyqane tregtare, institucione fetare, arsim-kulture etj., të cilat shënojnë një rregullim më të spikatur urban të Gjakovës. Në fillim të viteve'90 popullsia e këtij qyteti arriti në 75000 banorë.

Gjakovë, a town in the Tableland of Dukagjin (Rrafshi i Dukagjinit), between Prizren and Pejë, is situated in the intersection of the Shkodër-Kosova Road (known in the ancient times a Via de Zenta) with the road passing through the main towns of the Tableland: Pejë, Gjakovë and Prizren. The town it's surrounded by the Erenik River and it's tributaries, Trakanica and Krena. The ancient traces of Gjakova date back to the Illyrian period of the Dardans. The findings in the ruins beyond the Babac Bridge, on the western side of the Erenik River, are considered to belong to the ancient town of Grabuleo, a name encountered in themaps of the 1st-4th centuries. The medieval period is characterized by the construction of bridges, shops, mosques and other religious, cultural and educational institutions, which marked a more conspicuous urban arraangement of Gjakovë. In the early 1990's Gjakovë had a population of 75,000 inhabitants.

Veshjet e krahinës së Rugovës, Kosovë

Folk costumes of the region of Rugovë, Kosovë

Ura e Terëzijve (mesjetë), Gjakovë.

The medieval Tailors' Bridge (Ura e Terezijve), Gakovë.

PRISHTINA

Prishtina, kryeqyteti i Kosovës, me popullsi mbi 270000 banorë. Qyteti shtrihet nëpër luginën e Vellushës në drejtim nga ana perëndimore e Fushë-Kosovës. Këtu janë gjetur objekte arkeologjike të viteve 3000-2500 p.e.r. Pranë Prishtinës gjenden rrënojat e Ulpianës, qytet antik i Dardanisë. Në shek.III-IV, ky qytet u konsolidua si qendër administrative e provincës ilire të Dardanisë. E shkatërroi tërmeti i vitit 518, por u ndërtua nga Justiniani i Madh dhe mori emrin e tij Justiniana Sekunda, sot Prishtina. Në shek.XII-XIV, bëhet qendër e jetës politike. Në vijim, deri në shek.XIX merr edhe formë urbane, sidomos kur u ndërtua rrjeti hekurudhor Mitrovicë-Selanik. Zhvillimi i Prishtinës si një metropol rajonal dhe ndërajonal, fillon kur ajo merr funksione si qendër administrative e Qarkut Autonom dhe më vonë Krahinë Autonome e Kosovës. Nxjerrja e qymyrgurit linjit, prodhimi i energjisë elektrike, plumbit, zinkut etj, në afërsi të Prishtinës, rritja ekonomik solli zgjerimin e qytetit dhe rritjen e popullsisë. Lufta dhe sakrificat e mëdha për liri dhe demokraci të rinisë, studentëve, banorëve të Prishtinës dhe të popullit shqiptar në Kosovë, me ndihmën edhe të faktorit ndërkombëtar, së fundi u kurorëzuan me çlirimin e Kosovës nga okupatori serb dhe ngritjen e institucioneve politike duke e futur kështu Kosovën përfundimisht në rrugën e ndërtimit të demokracisë, pavarësisë dhe integrimit evropian.

Prishtina, the capital of Kosova, has a population of 270,000 inhabitants. The city is situated in the valley of Vellusha on the western side of the Kosova Plain (Fushë-Kosovë). Archeological objects of the years 3000-2500 BC have been found here. Near Prishtina there are ruins of Ulpiana, the ancient town of Dardania. In the 3rd-4th centuries, this city was consolidated as the administrative centre of the Illyrian province of Dardania. It was destroyed by the earthquake of the year 518, but it was rebuilt by Justinian the Great and was named after him as Justiniana Secunda (later called Prishtina). In the 12th-15th centuries, it became a commercial and political centre. Gradually, until the 19th century, its urban shape is completed, especially after the construction of the railroad Mitrovica-Selanik. Then, in the 20th century, Prishtina's development as a regional and interregional metropolis started when it assumed functions as the administrative centre of the Autonomous District and later as the Autonomous Region of Kosova.

Brown coal (lignite) mining and production of electric power, lead, zinc, etc., near Prishtina enlarged the city, raised its economic importance and increased its population.

The struggle and great sacrifices for freedom and democracy of the youth, students and citizens of Prishtina and of the whole Albanian people of Kosova, strongly supported by the international factor, were finalized with the liberation of Kosova from Serb occupation and the establishment of political institutions. In this way Kosova has definitely entered into the road of democratic construction and European integration.



Azem Galica (1889-1924). Luftëtar për liri dhe bashkim kombëtar nga Kosova. Udhëhoqi lëvizjen e armatosur kundër pushtuesve serbë (1912-1924) dhe kundër atyre austriakë dhe bullgarë (1915-1918). Organizator i kryengritjes së Rrafshit të Dukagjinit (1919). Ra në luftimet e Drenicës.

Azem Galica (1889-1924) is an Albanian fighter for freedom and national unity from Kosova. He led the armed uprisings against Serb invaders (1912-1924) and against Austrian and Bulgarian invaders (1915-1918). He was the organizer of the uprising of the Tableland of Dukagjin (Rrafshi i Dukagjinit) (1919). He was killed in the Drenica fightings.

Shote Galica (1895-1927). Heroinë e Popullit. Bashkëluftëtare dhe gruaja e Azem Galicës. Sakrifikoi në luftë për çlirimin e Kosovës dhe bashkimin kombëtar. E veshur si burrë, pas rënies së Azemit, udhëhoqi çetën në aksione luftarake kundër pushtuesve serbë.

Shotë Galica (1895-1927), "The People's Heroine", was Azem Galica's wife and co-fighter. She sacrificed her life for the national unity and liberation of Kosova. Dressed up in man's clothes after her husband's death, she led the Albanian insurgents in military actions against Serb invaders.

Monumenti i Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Prishtinë.
(Vepër e Skulptorit të Popullit, Janaq Paço).

The Monument of George Castriot Skanderbeg in Prishtina
(A sculpture of the "People's Sculptor" Janaq Paço).

Adem Jashari (1955-1998). Lindi në Prekaz të Drenicës, Kosovë. Komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe një nga themeluesit e saj. Hero legjendë që ra për çlirimin e Kosovës. Në luftën e viteve (1998-1999) në Kosovë, nga fisi Jashari u vranë 56 veta

***Adem Jashari** (1955-1998) was born at Prekaz, Drenitsa, in Kosova. He was Commander of the UÇK (Kosova Liberation Army) and one of its founders. He was a legendary hero who laid down his life for the liberation of Kosova. Fifty-six members of the Jashari tribe were killed in the Kosova war of 1998-1999.*

Shqiptarë të diasporës

Miliona shqiptarë nga Shqipëria, Kosova dhe treva te tjera shqiptare, ndër shekuj mërguan në Turqi, Greqi, Itali, Zvicër, Gjermani, Belgjikë, Angli, Amerikë, Kanada, Australi etj. Gjysma e popullsisë të kombit shqiptar jeton e punon në diasporë. Afërsisht aq sa jetojnë sot brenda trojeve etnike.

Ish-kongresmeni amerikan me origjinë shqiptare **Jozef Dio-guardi** midis ish-të përndjekurve politikë në Tiranë. Veprimtar i shquar politik për çështjen kombëtare shqiptare.

*The former American congressman of Albanian origin **Joseph Dioguardi**, a distinguished political activist for the Albanian national cause, among politically ex-persecuted people in Tirana.*

Anton Athanas, lindur në Korçë. Shqiptaro-amerikan, atdhetar dhe biznesmen i shquar në Boston, Amerikë

***Anton Athanas**, born in Korça. Albanian-U.S. patriot and renown businessman in Boston (USA)*

Ibrahim Kodra (1918-2006), shqiptar me banim ne Itali. Piktor modernist. Ne Art Club te Romës 1948, u takua me Pikason. Krijimtaria e tij e parë u radhit me ato të piktorëve më të shquar të kohes. Ka ndihmuar per njohjen dhe lartesimin e kombit shqiptar. Ka marre Urdhrin "Nder I Kombit" (1985).

***Ibrahim Kodra** (1918), an Albanian living in Italy. He is a modernist painter. He met Picasso in the Art Club of Rome in 1948. His first paintings helped him to be included among the most distinguished painters of our times. He has contributed to make the Albanian nation known and respected all over the world. He has received the Order "Honour of the Nation in 1985).*

Eliza Dushku. Lindur në Boston, (vjeç 25), me origjinë shqiptare. Aktore e talentuar e kinematografisë hollivudiane. Vizitoi Tiranën dhe Prishtinën 2006.

***Eliza Dushku**, 25 years old, born in Boston, of Albanian origin- a talented actress of Hollywood cinematography.*
Visited Tirana and Prishtina



Xhejms Belushi (1954). Aktor amerikan me origjinë shqiptare. Radhitet në yjet e kinoaktorëve amerikanë. I vëllai i Xhon Belushit, edhe ky skenarist, regjisor, këngëtar dhe aktor komik i famshëm në Amerikë.

***James Belushi** (b. 1954), an American actor of Albanian origin, ranks among the American film stars. His brother, John Belushi, was also a famous comic actor, singer and film director in the United States.*

Xhorxh Gordon Bajron, lord (George G.Byron, 1788-1824). Poet romantik anglez. Lindi në Londër. Mik i sinqertë i shqiptarëve. Në veprën e tij «Shtegtimet e Çajld Haroldit» (kënga e dytë) vlerësohen cilësitë burrërore, trimëritë, fisnikëria dhe mikpritja e shqiptarëve.
Portret i Bajronit me kostum shqiptar (Th.Philips Galeria e Arteve, Londër).

*Lord **George G. Byron**, (1788-1824) was an English romantic poet. He was a great friend of the Albanian people. In his work "Childe Harold's Pilgrimage" (Second Canto) he appreciates the Albanian manly character, traditions of hospitality and generosity, their nobility, fidelity and bravery.*

Mis Edith Durham (1864-1943). Personalitete angleze. Etnografe dhe publiçiste. Në veprat që i shkroi gjatë udhëtimit nëpër Ballkan, mbrojti çështjen kombëtare shqiptare.

***Miss Edith Durham** (1864-1943) was a distinguished English personality, ethnographer and journalist. In her books, which she wrote during her journeys in the Balkans, she supported the Albanian national cause for independence.*

Toni Bler (1954). Burrë shteti anglez, laburist, Kryeministër (1997). Dhe vazhdon me një mandat të tretë ai së bashku me Bill Klinton-luajtën rol vendimtar në çlirimin e Kosovë (1999).

***Tony Blaire** (b. 1954) , a British statesman of the Labour Party, and Prime Minister of the United Kingdom (1997). And continues with a third mandate. Together with Bill Clinton, he played a crucial role in Kosovo's liberation (1999)*

PESHKOPIA

Peshkopia është një qytet relativisht i ri i Shqipërisë verilindore. Megjithatë, burimi i këtij emri duhet të jetë i periudhës paraosmane. Emri i qytetit lidhet me ekzistencën e një qendre klerikale(ipeshkvi, episcopate, peshkopatë), që shkon deri te kjo periudhë. Ka edhe një interpretim tjetër, popullor, për prejardhjen e këtij emri duke e lidhur me themelimin e qytetit prej "pesë shtëpish", që më pas u tha "Peshkopi".

Ka një popullsi prej rreth 20000 banorë. Qyteti i Peshkopisë nuk i kishte tiparet e një "shehri" në periudhën parakombëtare, megjithëse ishte bërë një qendër urbane me rëndësi. "Shehri" ishte në Dibër të Madhe, përkundruall Peshkopisë që njihej si Dibra e Vogël. Qyteti i Dibrës është kryeqendra etnografike e zonës, e cila përbëhej prej "nëntë malesh" (flamujsh apo bajraqesh) dhe jallisë (fushës). Dibra është një qytet i hershëm i periudhës parasllave. Fakti që ky qytet njihet me të njëjtin emër edhe nga sllavët (me një variant fonetik të vogël- "Debar") tregon pamundësinë e ndryshimit të toponimit nga popullsia ardhëse.

Dibra është një krahinë që përshkohet mes për mes nga Drini i Zi. Lugina e Drinit përbën zonën bujqësore të krahinës, kurse malet përbëjnë zonën blegtorale.

Peshkopi is a relatively new city of Northeast Albania, though the origin of its name should be of the pre-Ottoman period. The name of this city is related to the existence of a clerical centre (ipeshkvi -> episcopate -> peshkopata -> Peshkopi) of that period. There is also another interpretation though, relating it to the words "pesë shtëpi" (Engl. "Five houses"), which later might have been transformed into "Peshkopi".

Peshkopi didn't have the characteristics of a town in the period preceding the national revival (mid-19th century), though it had already become an important urban area. The municipality was located in Dibër e Madhe (Engl.Big Dibër) facing Peshkopi, which was known as Dibër e Vogël (Small Dibër). The city of Dibër was the ethnographic municipality of this region, which consisted of "nine mountains" (flags or clans), and of the lowland. Dibër is an ancient city of the pre- Slavic period. The fact that this city is recognised by a phonetically alternative name ("Debar") by the Slavs shows that it was impossible for the late-comers of the 6th -7th centuries to change the toponymy of the city.

The Black Drin (river in Northeast Albania) flows across the region of Dibër. The valley of Drin constitutes the agricultural area of this region, while the surrounding mountains make up the pasturage for the livestock.

Në Kurorën e Luës, Dibër

From the Garland of Lura, Dibër





Pas një pylli sterr të zi,
Diell, zambakë në liqen,qetësi.
Këtu është parajsa,
Pak përjetësi.

Autori

Behind a very dark forest,
The sun, the lilies in the lake, the silence,
Here is the Paradise,
The small kingdom of immortality.

The author

Pranverë në Lurë. Liqeni i Zi, më i madhi ndër 12 liqejtë e parkut kombëtar të Lurës.

Spring in Lura. The Black Lake, the largest lake among 12 in the Lura Park.

Ura e Tabakëve (1857), Tiranë.

The Tabak Bridge (1857), Tiranë.

Kthetra që shuanin etje! Tiranë (1991).

Claws which quenchings the thirst! Tiranë (1991).



Ismail Kadare. Shkrimtar.

The writer Ismail Kadare.

Bukuria shqip Albanian Beauty

Fryn fllad shqiptar, Tiranë.
An Albanian breeze, Tiranë.

Flamuri përmbledh kujtimet e shkuara të një kombi në një gjuhë të pashkruar që mund ta kuptojë syri dhe zemra e çdo njeriu me ndjenjë. Cilat janë kujtimet që shfaq duke valuar Flamuri ynë? Nuk janë kujtime goditjesh kundra fqinjëve, nuk janë kujtime lakmirash edhe rrëmbimesh; janë kujtime vetmbrojtjeje me mundime të palodhura dhe me trimërira të gjata e të forta, që kanë lënë gjurmë në letërsitë e të gjithë popujve të qytetëruar. Nga kjo pikëpamje mund të mburremi se Flamuri ynë, siç është një nga më të vjetrit e botës, është edhe një nga më të drejtët.

Faik. Konica

The Flag sums up the ageless and everlasting memories of a nation in an unwritten language, which may be understood only by the eye and the heart of every sensitive man. Which are the memories that our Flag unfolds as it waves endlessly? They aren't memories of attacks against our neighbours, nor of envy, greed and rapacity; they are only memories of self-defense nourished by endless efforts, endurance and sacrifices, by long and strong bravery, which have left their imprint in literatures of all civilized nations. From this point of view we may be proud of our Flag, which is not only one of the oldest of the world, but also one of the most upright and just.

Faik Konica

Jeronim De Rada (1814-1903). Lindi në Maki të Kalabrisë. Arbëresh, figurë madhore e Rilindjes sonë Kombëtare. Poet, publicist, filolog, mësues i Popullit. Studioi për drejtësi në Napoli. Botoi gazetën "L'Albanese d'Italia". Botime: Parimet e estetikës, Lashtësia e kombit shqiptar, "Rapsodia e një poeme arbëreshe", "Këngët e Milosaos", Skënderbeu i pafan, etj. Shkroi për çështjen e prejardhjes shqiptare dhe të gjuhës shqipe. Organizues i dy kongreseve gjuhësore të shqipes (1895 dhe 1897).

